



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 26.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.09.2024 me titull Servisimi i aparaturave në QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike Nr. të Prok: 635-23-13870-2-2-1 dhe nr i brendeshen 635-23-111-221 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. “ . të datë 25.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi i aparaturave në QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike Nr. të Prok: 635-23-13870-2-2-1 dhe nr i brendeshen 635-23-111-221nxjerr:

kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të datës 20.09.2024 të publikuar në platformën elektronike të E- Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 20.09.2024

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. me datën 20.09.2024, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Servisimi i aparaturave në QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike me Nr. të Prok: 635-23-13870-2-2-1 nr i 635-23-111-221 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 26.09.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kërkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 25.09.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur në përfundim se njehta eshte e pa bazuar.,

Pergjegjia nga A,K 1,

Në emër të Autoritetit Kontraktues (AK) dhe Komisionit Ri Vlersues, ju njoftojmë se kemi vepruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores Nr. 001/2022. Pas shqyrtimit të ankesës së OE URANIKU, kemi konstatuar se ajo ishte pjesërisht e bazuar.

Sipas Neneve 72 dhe 59 (1) të LPP-së, kemi kërkuar sqarime shtesë për ofertat e paraqitura. Me datë 12.09.2024, iu dërguam një letër standarde për kërkesën e sqarimeve për OE URANIKU SG. Në përgjigje, OE dorëzoi sqarimet e nevojshme më datë 16.09.2024. Komisioni Ri-vlersues e shqyrtoi dhe miratoi këto sqarime, duke përfshirë pretendimet ankimore.


Pas kësaj rivlerësimi, ne si AK konkludojmë se pretendimet ankimore të OE PRO MEDICAL SH.P.K janë të pabazuara dhe kemi vepruar në përputhje me LPP-në.

Po ashtu po ua perciellim edhe sqarimet e bera dhe pergjigjet nga OE i propozuar per kontrat

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit



Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.

PROCEDURAT E SHITJES	1.1. PROKURIMI I SHITJES
ANKESAT	1.2. PROKURIMI I SHITJES
PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	1.3. PROKURIMI I SHITJES
PROKURIMET QENDRORE	1.4. PROKURIMI I SHITJES
MENAXHIMI I KONTRATËS	1.5. PROKURIMI I SHITJES
MARRËVESHJET KORNIZE	1.6. PROKURIMI I SHITJES
ANKANDET REVERSE	1.7. PROKURIMI I SHITJES
ANKANDET	1.8. PROKURIMI I SHITJES
RAPORTET	1.9. PROKURIMI I SHITJES
NJOFTIMET - PROKURIMET	1.10. PROKURIMI I SHITJES
NJOFTIMET - SHITJE	1.11. PROKURIMI I SHITJES
KONTRATAT E DHËNA	1.12. PROKURIMI I SHITJES
MARRËVESHJET KORNIZE DHËNA	1.13. PROKURIMI I SHITJES
KLASIFIKIMI LIGJËDOR	1.14. PROKURIMI I SHITJES
TE DHËNAT E MIA	1.15. PROKURIMI I SHITJES
MESAZHET	1.16. PROKURIMI I SHITJES

Operatori ekonomik

URANIKU-SG SH.P.K.

Subjekti URANIKU-SG SH.P.K.

Ruaj

Anulo

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

KOMUNA E PEJES, Hasan Prishtina, PN 30000 Pejë

DATA: 12.09.2024

OE : " URANIKU-SG SH.P.K,

Nr. i prokurimit:	635-23-13870-2-2-1
Nr i brendshëm	635-23-111-221

Titulli: LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Gjate RI-Vlersimit te ofertes se juaj nga Komisioni Vlersues ka kerkuar sqarime shtes duke u mbeshtetur ne Nenin 72 te LPP-se dhe Nenin 59 (1) te LPP-se . Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve ofertes UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Sqarime 1.

*Ne si AK dhe Komisioni i Ri-vlersimit kerkon nga ana juaj qe ne dosien e juaj te tenderit keni prezantuar listen e puneve te kryera per 3 vitet e fundite dhe me to keni bashkangjitur **REFERENCA** , per perfundim te puneve andaje per te qene ma transparent dhe duke e respektuar **Nenin 72 te LPP-se dhe duke respektuar vendimin e OSHP-se me nr te ankeses 2024/0427 te dates 21.08.2024** ne si AK dhe komisioni ri-vleruses kerkon te na dokumentoni **KONTRATA E NENSHKRUARA per keto 10 projekte te cilat ju keni prezantuar ne Dosien e juaj***

Sqarime 2.

*Po ashtu te sqarimi 2 duke e respektuar **Nenin 59 te LPP-se dhe duke respektuar vendimin e OSHP-se me nr te ankeses 2024/0427 te dates 21.08.2024** ne si AK dhe komisioni rivleruses kerkon te na japni **Sqarime lidhur me cmimet e ofruara nga ana juaj si OE , pasi qe komisioni rivlersues kerkon te di se ju si OE si keni menduar ta realizoni kete kontrat me keto cmime te ofruara nga ana juaj dhe a i qendroni mbrapa ketyre qmimeve te ofruara ju si OE.***

Andaj ju njoftojm se ne si A.K kerkojm te na sqaroni me shkrim sqarimet e kerkuara lidhur me SQARIMIN 1 dhe SQARIMIN 2

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim deri me datën: **18.09.2024** ne ora **15:00** . Per ndonje pa qartesi mund te na drejtoheni **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks- apo në e-mailit **milot.r.gashi@rks-gov.net & sokol.katanolli@rks-gov.net**.

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt, Milot GASHI

Menaxher i Prokurimit KK Peje



Agjencioni për financim në Kosovë

KONTRATË PËR SHITBLERJE

dhe mirëmbajtjen e paisjeve të shitura

afk	Agjencioni për Financim në Kosovë Institucion Mikrofinanciar
Numri i protokollit <u>04/19</u>	
Nr. i faqeve <u>2</u>	
Data <u>07.02.2019</u>	
Pejë	

Palët kontraktuese

1. **Shitësi:** SH.P.K. "URANIKU"- SG, me numër fiskal 600445226 me seli fsh. Buqan K.K. Pejë, të cilën e përfaqëson SMAJL GASHI, në tekstin e mëtejme shitësi.
2. **Blerësi:** Agjencioni për Financim në Kosovë, me numër të regjistrimit 5200065-3, me seli në Pejë rr. Lidhja e Prizrenit Nr.1, Pejë, të cilën e përfaqëson Menaxheri i Operacioneve Xhevdet Spahija, në tekstin e mëtejme qiramarrësi.

1.Objekti

1.1 Shitësi do ta shesë-furnizoj blerësit paisje për Ngrohje Qendrore dhe paisje për klimatizim, dhe të njejtat do ti servisoj dhe mirëmbaj në mënyrë të rregullt dhe sipas natyrës së paisjeve.

2.Garancia

2.1 Shitësi garanton, se mallrat që i shet sipas kësaj kontrate, janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit ose aktual, varësisht sipas porosisë së blerësit, janë sipas specifikacionit dhe të afta për qëllimin e tyre.

2.2 Shitësi garanton blerësit për rregullsinë e mallit të shitur dhe funksionimin e tij për periudhë të caktuar kohore, e cila do të përcaktohet me fletëgarancion të vaçantë për secilin mall të shitur veç e veç.

2.3 Shitësi më tutje garanton se mallrat e shitura nuk kanë asnjë të metë, dhe se, në rast se paisjet e shitura do të dorëzohen me ndonjë të metë apo të kualitetit të dobët, blerësi ka të drejtë ta informojë shitësin për këtë, dhe të kërkojë që të metat e tilla shitësi ti evitoj, apo ti kthejë dhe ti zevëndësoj paisjet me të meta, me paisje funksionale, e atë në afat prej 5 ditë.

2.4 Për çdo lëshim të afatit të cekur në pikën 2.3 të kësaj kontrate shitësi i përgjigjet blerësit konform dispozitave të ligjit në fuqi.

3.Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm

3.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate përfshinë periudhën nga data e nënshkrimit të palëve kontraktuese, e deri me datën e skadimit dt. **31/12/2019**.

3.2 Palët kontraktuese u pajtuan për mundësinë e vazhimit të kësaj kontrate, për çka, në rastin e tillë do të lidhet kontratë e veçantë.

3.3 Palët kontraktuese kanë të drejtë që, në diskrecion të tyre, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, ta anulojnë të njejtën para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për zhdëmtim duke informuar palën tjetër me shkrim për synimin e tij për anulimin e kësaj kontrate, me njoftim paraprak në afat prej (30) tridhjetë ditë më parë.

3.4 Pas skadimit të kohëzgjatjes së kësaj kontrate, pa pasur nevojë për njoftim me shkrim, mosvazhdimi i të njejtës, do të konsiderohet mosvazhdim i raportit kontraktual në mënyrë të heshtur.

4. Dorëzimi dhe Pagesa

4.1 Për çdo paisje të porositur, objekt i kontratës, dorëzimi do të konsiderohet i kryer, pasi që shitësi ta ketë bërë transportimin, montimin dhe pas përfundimit të kënaqshëm të të gjitha testeve pranuese.

4.2 Pas dorëzimit pranimit të paisjeve objekt i kontratës, blerësi obligohet të bëjë pagesën e vlerës së fatures të dorëzuar nga shitësi, sipas afatit të cekur në fatur.

4.3 Çmimi për paisjet objekt i kontratës do të caktohen sipas kushteve të ofertimit.

4.4 Pagesa e vlerës së fatures do të bëhet në xhirollogarinë bankare të shitësit, e cekur në fatur.

5. Kontestet dhe ligji i aplikueshëm

5.1 Kjo Kontratë e qiradhënies i nënshtrohet ligjit të Kosovës.

5.2 Palët pajtohen këtu, se të gjitha paditë ose procedurat që dalin në lidhje me këtë Kontratë do të gjykohen ekskluzivisht në gjykatën me juridiksion kompetent në Republikën e Kosovës.

5.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate shpallet nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, pjesa tjetër e kësaj Kontrate nuk do të ndikohet nga ajo shpallje.

5.4 Në vend të dispozitës së kësaj Kontrate që është shpallur nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, një dispozitë do të shtohet si pjesë e kësaj Kontrate me terme të ngjashme me ato të dispozitës të pavlefshme apo të pazbatueshme, siç do ta bënte të mundshme dhe të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme.

6. Gjithëpërfshirja

6.1 Kjo Kontratë përmban tërë marrëveshjen në mes të palëve.

6.2 Çfarëdo amandamentimi, ndryshimi, modifikimi, apo shtimi i kontratës, nuk do të jetë i vlefshëm, përpos nëse është me shkrim dhe i nënshkruar nga të dy palët.

7. Kopjet/Nënshkrimet

7.1 Kjo Kontratë do të nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike, dhe secila kopje konsiderohet origjinal i kontratës, dhe secila palë kontraktuese do të mbajë 1 (një) të tillë.

NË PAJTIM MË TËRË KËTË, palët kanë vendosur këtu nënshkrimet dhe vulat e tyre me dt. 01/01/2019.

P ë r: blerësin:

z. Xhevdet Spahija
Menaxher i Operacioneve



P ë r: shitësin

z. Smajl Gashi



KONTRATË PËR SHITBLERJE

dhe mirëmbajtjen e paisjeve të shitura

afk	Agjencioni për Financim në Kosovë Institucion Mikrofinanciar
Numri i protokolit	03/20
Nr. i faqeve	2
Data	16.01.2020
Pejë	

E nënshkruar me datë 03.01.2020 (data efektive e kontratës nga 01/01/2020)

1. Shitësi: SH.P.K. "URANIKU"- SG, me numër fiscal 600445226 me seli fsh. Buqan K.K. Pejë, të cilën e përfaqëson SMAJL GASHI, në tekstin e mëtejshme shitësi.
2. Blerësi: Agjencioni për Financim në Kosovë, me numër të regjistrimit 5200065-3, me seli në Pejë rr. Lidhja e Prizrenit Nr.1 Pejë, të cilën e përfaqëson Menaxheri i Operacioneve Xhevdet Spahija, në tekstin e mëtejshme blerësi.

1.Objekti

1.1 Shitësi do ta shesë-furnizoj blerësit paisje për Ngrohje Qëndrore dhe paisje për klimatizim, dhe të njëjtat do ti servisoj dhe mirëmbaj në mënyrë të rregullt dhe sipas natyrës së paisjeve.

2.Garancia

2.1 Shitësi garanton, se mallrat që i shet sipas kësaj kontrate, janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit ose aktual, varësisht sipas porosisë së blerësit, janë sipas specifikacionit dhe të afta për qëllimin e tyre.

2.2 Shitësi garanton blerësit për rregullsinë e mallit të shitur dhe funksionimin e tij për periudhë të caktuar kohore, e cila do të përcaktohet me fletëgarancion të vaçantë për secilin mall të shitur veç e veç.

2.3 Shitësi më tutje garanton se mallrat e shitura nuk kanë asnjë të metë, dhe se, në rast se paisjet e shitura do të dorëzohen me ndonjë të metë apo të kualitetit të dobët, blerësi ka të drejtë ta informojë shitësin për këtë, dhe të kërkojë që të metat e tilla shitësi ti evitoj, apo ti kthejë dhe ti zëvendësoj paisjet me të meta, me paisje funksionale, e atë në afat prej 5 ditë.

2.4 Për çdo lëshim të afatit të cekur në pikën 2.3 të kësaj kontrate shitësi i përgjigjet blerësit konform dispozitave të ligjit në fuqi.

3.Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm

3.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate përfshinë periudhën nga data e nënshkrimit të palëve kontraktuese, e deri me datën e skadimit dt. 31/12/2020.

3.2 Palët kontraktuese u pajtuan për mundësinë e vazhimit të kësaj kontrate, për çka, në rastin e tillë do të lidhet kontratë e veçantë.

3.3 Palët kontraktuese kanë të drejtë që, në diskrecion të tyre, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, ta anulojnë të njëjten para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për zhdëmtim duke informuar palën tjetër me shkrim për synimin e tij për anulimin e kësaj kontrate, me njoftim paraprak në afat prej (30) tridhjetë ditë më parë.

3.4 Pas skadimit të kohëzgjatjes së kësaj kontrate, pa pasur nevoj për njoftim me shkrim, mosvazhdimi i të njejtës, do të konsiderohet mosvazhdim i raportit kontraktual në menyrë të heshtur.

4. Dorëzimi dhe Pagesa

4.1 Për çdo paisje të porositur, objekt i kontratës, dorëzimi do të konsiderohet i kryer, pasi që shitësi ta ketë bërë transportimin, montimin dhe pas përfundimit të kënaqshëm të të gjitha testeve pranuese.

4.2 Pas dorëzim pranimit të paisjeve objekt i kontratës, blerësi obligohet të bëjë pagesen e vlerës së fatures të dorëzuar nga shitësi.

4.3 Çmimi për paisjet objekt i kontratës do të caktohen sipas kushteve të ofertimit.

4.4 Pagesa e vlerës së fatures do të bëhet në xhirollogarinë bankare të shitësit, e cekur në fatur.

5. Kontestet dhe ligji i aplikueshëm

5.1 Kjo Kontratë e qiradhënies i nënshtrohet ligjit të Kosovës.

5.2 Palët pajtohen këtu, se të gjitha paditë ose procedurat që dalin në lidhje me këtë Kontratë do të gjykohen ekskluzivisht në gjykatën me juridiksion kompetent në Republikën e Kosovës.

5.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate shpallet nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, pjesa tjetër e kësaj Kontrate nuk do të ndikohet nga ajo shpallje.

5.4 Në vend të dispozitës së kësaj Kontrate që është shpallur nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, një dispozitë do të shtohet si pjesë e kësaj Kontrate me terme të ngjashme me ato të dispozitës të pavlefshme apo të pazbatueshme, siç do ta bënte të mundshme dhe të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme.

6. Gjithëpërfshirja

6.1 Kjo Kontratë përmban tërë marrëveshjen në mes të palëve.

6.2 Çfarëdo amandamenti, ndryshimi, modifikimi, apo shtimi i kontratës, nuk do të jetë i vlefshëm, përpos nëse është me shkrim dhe i nënshkruar nga të dy palët.

7. Kopjet/Nënshkrimet

7.1 Kjo Kontratë do të nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike, dhe secila kopje konsiderohet original i kontratës, dhe secila palë kontraktuese do të mbajë 1 (një) të tillë.

NË PAJTIM MË TËRË KËTË, palët kanë vendosur këtu nënshkrimet dhe vulat e tyre me dt. 03.01.2020.

Për blerësin:

z. Xhevdet Spahija

Menaxher i Operacioneve



Për shitësin

z. Smajl Gashi



KONTRATË PËR SHITBLERJE

dhe mirëmbajtjen e paisjeve të shitura

E nënshkruar me datë 04.01.2021(data efektive e kontratës nga 01/01/2021)

1. **Shitësi:** SH.P.K. "URANIKU"- SG, me numër fiscal 600445226 me seli fsh. Buqan K.K. Pejë, të cilën e përfaqëson SMAJL GASHI, në tekstin e mëtejme shitësi.
2. **Blerësi:** Agjencioni për Financim në Kosovë, me numër të regjistrimit 5200065-3, me seli në Pejë rr. Lidhja e Prizrenit Nr.1 Pejë, të cilën e përfaqëson Menaxheri i Operacioneve Xhevdet Spahija, në tekstin e mëtejme blerësi.

1.Objekti

1.1 Shitësi do ta shesë-furnizoj blerësit paisje për Ngrohje Qëndrore dhe paisje për klimatizim, dhe të njejtat do ti servisoj dhe mirëmbaj në mënyrë të rregullt dhe sipas natyrës së paisjeve.

2.Garancia

2.1 Shitësi garanton, se mallrat që i shet sipas kësaj kontrate, janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit ose aktual, varësisht sipas porosisë së blerësit, janë sipas specifikacionit dhe të afta për qëllimin e tyre.

2.2 Shitësi garanton blerësit për rregullsinë e mallit të shitur dhe funksionimin e tij për periudhë të caktuar kohore, e cila do të përcaktohet me fletëgarancion të vaçantë për secilin mall të shitur veç e veç.

2.3 Shitësi më tutje garanton se mallrat e shitura nuk kanë asnjë të metë, dhe se, në rast se paisjet e shitura do të dorëzohen me ndonjë të metë apo të kualitetit të dobët, blerësi ka të drejtë ta informojë shitësin për këtë, dhe të kërkojë që të metat e tilla shitësi ti evitoj, apo ti kthejë dhe ti zëvendësoj paisjet me të meta, me paisje funksionale, e atë në afat prej 5 ditë.

2.4 Për çdo lëshim të afatit të cekur në pikën 2.3 të kësaj kontrate shitësi i përgjigjet blerësit konform dispozitave të ligjit në fuqi.

3.Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm

3.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate përfshinë periudhën nga data e nënshkrimit të palëve kontraktuese, e deri me datën e skadimit dt. 31/12/2021.

3.2 Palët kontraktuese u pajtuan për mundësinë e vazhimit të kësaj kontrate, për çka, në rastin e tillë do të lidhet kontratë e veçantë.

3.3 Palët kontraktuese kanë të drejtë që, në diskrecion të tyre, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, ta anulojnë të njejtën para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për zhdëmtim duke informuar palën tjetër me shkrim për synimin e tij për anulimin e kësaj kontrate, me njoftim paraprak në afat prej (30) tridhjetë ditë më parë.

3.4 Pas skadimit të kohëzgjatjes së kësaj kontrate, pa pasur nevoj për njoftim me shkrim, mosvazhdimi i të njejtës, do të konsiderohet mosvazhdim i raportit kontraktual në menyrë të heshtur.

4. Dorëzimi dhe Pagesa

4.1 Për çdo paisje të porositur, objekt i kontratës, dorëzimi do të konsiderohet i kryer, pasi që shitësi ta ketë bërë transportimin, montimin dhe pas përfundimit të kënaqshëm të të gjitha testeve pranuese.

4.2 Pas dorëzimit pranimit të paisjeve objekt i kontratës, blerësi obligohet të bëjë pagesën e vlerës së fatures të dorëzuar nga shitësi.

4.3 Çmimi për paisjet objekt i kontratës do të caktohen sipas kushteve të ofertimit.

4.4 Pagesa e vlerës së fatures do të bëhet në xhironlogarinë bankare të shitësit, e cekur në fatur.

5. Kontestet dhe ligji i aplikueshëm

5.1 Kjo Kontratë e qiradhënies i nënshtrohet ligjit të Kosovës.

5.2 Palët pajtohen këtu, se të gjitha paditë ose procedurat që dalin në lidhje me këtë Kontratë do të gjykojnë ekskluzivisht në gjykatën me juridiksion kompetent në Republikën e Kosovës.

5.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate shpallet nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, pjesa tjetër e kësaj Kontrate nuk do të ndikohet nga ajo shpallje.

5.4 Në vend të dispozitës së kësaj Kontrate që është shpallur nga gjykata e juridiksionit kompetent të jetë e pavlefshme apo e pazbatueshme, një dispozitë do të shtohet si pjesë e kësaj Kontrate me terme të ngjashme me ato të dispozitës të pavlefshme apo të pazbatueshme, siç do ta bënte të mundshme dhe të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme.

6. Gjithëpërfshirja

6.1 Kjo Kontratë përmban tërë marrëveshjen në mes të palëve.

6.2 Çfarëdo amandamenti, ndryshimi, modifikimi, apo shtimi i kontratës, nuk do të jetë i vlefshëm, përpos nëse është me shkrim dhe i nënshkruar nga të dy palët.

7. Kopjet/Nënshkrimet

7.1 Kjo Kontratë do të nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike, dhe secila kopje konsiderohet origjinal i kontratës, dhe secila palë kontraktuese do të mbajë 1 (një) të tillë.

NË PAJTIM MË TËRË KËTË, palët kanë vendosur këtu nënshkrimet dhe vulat e tyre me dt. 04.01.2021

Për blerësin:

z. Xhevdet Spahija

Menaxher i Operacioneve



Për shitësin

z. Smajl Gashi



K O N T R A T Ë

E lidhur me datën 01.03.2021 në mes të:

Punëdhënësit:

G&O CONSTRUCTION SH.P.K., me seli në Pejë me Nr.UI 810030982, të cilën e përfaqëson z. Kujtim Hadergjonaj në tesktin vijues *Punëdhënësit* në njërën anë dhe

Punëkryesit:

URANIKU-SG SHPK me adresë në Pejë, me Nr. UI 810409012, të cilën e përfaqëson z. Smajl Gashi në tesktin vijues *Punëkryesit*, janë pajtuar si në vijim:

INSTALIMIN E UJIT,NGROHJES QENDRORE,KLIMATIZIMIT DHE VENTILIMIT

Neni 1

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve për servisimin dhe mirembajtjen e ngrohjes qendrore,klimatizimit dhe hidroinstalimeve.

Nga ana e Punëkryesit sipas ofertës financiare që është pjesë përberëse e kësaj kontrate.

Neni 2

Mbikeqyrja e punimeve do te behet nga kompania **G&O Construction sh.p.k.**

Punëkryeresi kompania **Uraniku-SG shpk**, ofron garancion për shërbimet e punëkryerjes se punimeve ne **instalimin e ujit,ngrohjes qendrore,klimatizimit dhe ventilimit** prej 12(dymbëdhjet) muaj prej kohës së pranimit teknik të punëve nga ana e AK, gjatë kohës së garancionit kompania **Uraniku-SG shpk**, në rast të ndonjë defekti eventual është e obliguar të përgjigjet ne raste te defektit eventual në afat sa më të shpejt dhe pa asnjë kompenzim shtesë nga kompania për projektin **instalimi i ujit,ngrohjes qendrore,klimatizimit dhe ventilimit**. Punët do të fillojnë me **01.03.2021** dhe do të zgjasin deri më datë **10.10.2023**, përveq nëse kompania nuk do të ketë ndonjë pengesë.

Punët llogariten sipas ofertës së bërë nga kompania **Uraniku-SG shpk** komplet puna nga faza e fillimit deri në përfundimin e punimeve.

Në rast të ndryshimit të projektit kompania **Uraniku-SG shpk** është zotuar se çmimi i punimeve nuk ndryshon po jetë sikurse në ofertë.

Neni 3

Vlera e kontratës është: **48,685.00 €**

Pagesave të bëhet sipas situacioneve te kryerjes se punimeve nga **G&O Construction sh.p.k.**, pas pranimit të faturës nga kompania **Uraniku-SG shpk**.

Ç'do ndryshim që mund të shfaqet gjatë ekzekutimit të punëve bëhet me marrveshje të përbashkët mes dy palëve kontraktuese.

Neni 4

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 5

Kjo kontratë është e hartuar në 2 kopje identike, prej të cilave nga një i mbesin palëve kontraktuese.

Neni 6

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE:


PUNËDHËNËSI:

G&O CONSTRUCTION SH.P.K.




PUNËKRYERSI:

URANIKU-SG SH.P.K.






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

"URANIKU-SG" Sh.p.k.-Buqan, Pejë, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i kontratës : Mirëmbajtja nxemjeve qendrore, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit si dhe sistemit sanitar të institucioneve publike të Komunës së Deçanit

me numër identifikues: 631-19-8576-2-2-1 nr. I brendshëm : 631 19 057 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: Mirëmbajtja nxemjeve qendrore, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit si dhe sistemit sanitar të institucioneve publike të Komunës së Deçanit sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit dhe ofertës financiare, e që përmban 1.Servisimi dhe montimi I aparatura dhe pajisje për sistemin e ngrohjes 2.Servisimi dhe montimi i aparatura dhe pajisje për sistemin e klimës dhe ventilimit 3.Servisimi dhe montimi i aparatura dhe pajisje për sistemin e sanitarisë.

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë

“porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **29.11.2019** dhe përfundon në datën **29.11.2022**.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **20 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.**

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në **institucioneve publike të Komunës së Deçanit.**

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale e kontratës çmim total prej 40,731.17€ dhe çmim total i peshuar prej: 17,901.30€
Vlera e parashikuar e kontratës për periudhën **36 mujore është :124,000.00 Euro**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); 18.11.2019
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


